

Buletini i Financave Publike – Janar 2018

nga Instituti për Politikën Publike dhe Mirëqeverisjen

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë publikoi Statistikat fiskale për muajin Janar 2018. Në shërbim të analizës janë përdorur të dhënat kumulative për të ardhurat publike, shpenzimet qeveritare dhe investimet nga Shkurti 1998 deri në Janar 2018.

Duke analizuar ecurinë e financave publike, Presidenti i Nderit të IPPM-së, Z. Arben Malaj, shprehet:

“Gjatë muajit Janar 2018, realizimi i të ardhurave vjetore ka shënuar përmirësimin vetëm në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2017, por jo edhe në raport me mesataren e periudhës 10-vjeçare. Ndërsa shpenzimet totale të realizuara gjatë muajit Janar kanë treguar përmirësim krahasuar edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, edhe me mesataren e 10 viteve të fundit për këtë muaj. Edhe investimet publike gjatë muajit Janar, kanë performuar më mirë si krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ashtu edhe me atë të 10 viteve të fundit.

Krahasimet kryesore:

Të ardhurat publike për muajin Janar 2018 shënuan vlerën 35,391 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, vihet re një rritje në vlerë nominale prej 2,497 miliardë lekësh ose një rritje prej 7.6%.

Gjatë muajit Janar, të ardhurat e realizuara si pjesë e të ardhurave totale të planifikuara për Buxhetin e vitit 2018 ishin 7.62%, ndërsa pesha mesatare e të ardhurave të realizuara për muajin Janar të 10 viteve të fundit është në vlerën 7.74%. Pra, realizimi i të ardhurave për Janar 2018 ka rezultuar më dobët se mesatarja e periudhës 10 vjeçare, konkretisht me një diferencë prej 0.12 pikë përqindje.

Shpenzimet totale për muajin Janar arritën vlerën 30,028 miliardë lekë, duke shënuar një rritje në vlerë nominale prej 4,394 miliardë lekësh, ose një rritje prej 17.1% krahasuar me të njëjtin muaj për vitin 2017.

Për muajin Janar, pesha mesatare e shpenzimeve totale ndaj Buxhetit të këtij viti ka rezultuar 6.04%, ndërsa pesha mesatare e 10 viteve të fundit për këtë tregues ka qenë 5.77%. Në këtë aspekt mund të thuhet se shpenzimet totale për Janarin e vitit 2018 kanë performuar më mirë se mesatarja e periudhës 10 vjeçare, duke pësuar një rritje prej 0.27 pikë përqindje.



Instituti për Politikën Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv:
Ledjon Shahini

Regjistruar në Gjykatën e Tiranës,
Nr. Regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit, Nr.8,
Tiranë, Shqipëri

Investimet publike gjatë muajit Janar arritën vlerën 3,564 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, investimet publike mujore shënuan një rritje në vlerë nominale prej 2,523 miliardë lekë, ose një rritje prej 242.4%.

Analizë e mëtejshme e treguesve

Mbi bazën e të dhënave zyrtare të statistikave fiskale të publikuara nga Ministria e Financave është përgatitur një analizë më e fokusuar e treguesve kryesorë të financave publike.

Të ardhurat në buxhetin e shtetit

Totali i të ardhurave për muajin Janar 2018 shënoi vlerën 35,391 miliardë lekë, apo 2,497 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja prej 7.6% e të ardhurave të realizuara në terma vjetorë është shkaktuar nga rritja e të ardhurave tatimore dhe atyre nga ndihmat. Të ardhurat tatimore kanë shënuar vlerën 33,116 miliardë lekë, ose 2,181 miliardë lekë më shumë se në Janar 2017, duke pësuar një rritje prej 7.1%. Të ardhurat nga ndihmat kanë shënuar vlerën 92 milionë lekë, ose 94 milionë lekë më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rënie prej 50.5%.

Pesha mesatare e të ardhurave nga ndihmat për Janarin e vitit 2018 ndaj Buxhetit të këtij viti ka qenë 0.63%, ndërsa pesha mesatare për Janarin e 10 viteve të fundit ka qenë 3.59%, duke shënuar kështu një rënie prej 2.96 pikë përqindje.

Pesha mesatare e të ardhurave tatimore për Janarin e këtij viti ka rezultuar 7.8%, ndërsa pesha mesatare e periudhës 10 vjeçare për këtë tregues ka qenë 7.6%, duke shënuar një rritje prej 0.2 pikë përqindje.

Sipas Indeksit të IPPM, në muajin Janar, të ardhurat e realizuara si peshë e Buxhetit 2018 janë 0.12 pikë përqindje më pak se pesha mesatare e të ardhurave të realizuara për muajin Janar gjatë 10 viteve të fundit.

Shpenzimet totale

Për muajin Janar 2018, shpenzimet totale shënuan vlerën prej 30,028 miliardë lekë duke pësuar një rritje prej 4,394 miliardë lekësh në vlerë nominale, ose një rritje prej 17.1% krahasuar me Janarin e 2017, ndër të cilat 1,825 miliardë lekë kanë qënë nga rritja e shpenzimeve korrente. Shpenzimet korrente kanë rezultuar në vlerën 26,464 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 7.4% krahasuar me një të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv:
Ledjon Shahini

Regjistruar në Gjykatën e Tiranës,
Nr. Regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit, Nr.8,
Tiranë, Shqipëri

Pesha e shpenzimeve totale të realizuara gjatë muajit Janar 2018 ndaj totalit të këtyre shpenzimeve për këtë vit ka rezultuar 0.28 pikë përqindje më lartë se pesha mesatare për 10 vitet e fundit.

Pesha e shpenzimeve korrente për muajin Janar ndaj Buxhetit të këtij viti ka qenë 6.49%. Referuar Indeksit 10-vjeçar të IPPM-së, rezulton se pesha e shpenzimeve korrente të realizuara gjatë muajit Janar ndaj Buxhetit për 2018 është 0.07 pikë përqindje mbi mesataren 10 vjeçare të shpenzimeve korrente për këtë muaj.

Investimet publike

Investimet publike në muajin Janar 2018 arritën vlerën nominale 3,564 miliardë lekë, ose 2,523 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke pësuar një rritje prej 242.4%. Për këtë muaj nuk ka pasur investime publike me financim të brendshëm. Investimet publike janë financuar nga të ardhurat e Arsimit të Lartë në masën 10 milionë lekë dhe nga financimet e huaja, të cilat kanë qenë në vlerën 3,554 miliardë lekë dhe kanë shënuar një rënie prej 285.1% krahasuar me Janarin e vitit 2017.

Pesha e investimeve publike për muajin Janar ndaj Buxhetit të vitit 2018 rezulton 4.13%, ndërsa referuar Indeksit të IPPM-së, rezulton se pesha mesatare e investimeve publike të realizuara gjatë muajve Janar për 10 vitet e fundit është 3.67%. Në këtë aspekt mund të thuhet se ky tregues ka performuar më mirë krahasuar me periudhën 10-vjeçare, duke shënuar një rritje në masën 0.46 pikë përqindje.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv:
Ledjon Shahini


Regjistruar në Gjykatën e Tiranës,
Nr. Regjistrimi 389

Adresa: Rruga e ElbasaniT, Nr.8,
Tiranë, Shqipëri


Analiza Grafike e Buletinit të Financave Publike - Janar 2018

1. Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit


Të Ardhurat Totale dhe Indeksi i IPPM
Mil lekë




Të Ardhurat Mujore
Mil lekë



Pesha e të ardhurave mujore dhe Pesha mesatare e 10 - vjeçarit




Pesha e Të Ardhurave Mujore




2. Shpenzimet Totale


Shpenzimet e Qeverisë dhe Indeksi i IPPM
Mil lekë




Shpenzimet Mujore
Mil lekë




Pesha e shpenzimeve mujore dhe Pesha mesatare e 10 - vjeçarit




Pesha e Shpenzimeve Mujore




3. Investimet Publike




Investimet Publike Mujore
Mil lekë



Pesha e shpenzimeve për investimet publike mujore dhe Pesha mesatare e 10 - vjeçarit



Pesha e Shpenzimeve për Investimet Publike



FALEMINDERIT!

Për të marrë në kohë reale Buletinin e Financave Publike ju lutem na kontaktoni në secretary@ippm.al.

Informacione të mëtejshme në lidhje me analizën e përgatitur për Buletinin e Financave Publike mund të gjenden në:

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

www.ippm.al/buletiniifinancavepublike

Ministria e Financave, Statistikat mujore fiskale

www.minfin.gov.al